

PERMBLEDHJE

JO TEKNIKE

SUBJEKTI FATOS GEGA

AKTIVITETI : Prodhim, ambllazhim dhe tregti me shumice të ujit të pijshëm për njerëz, pije freskuese.(Ambllazhim Tregtim Uji të Pishëm)

Adresa : Rrajce, Fusheë Prrenjaz, Librazhd

Gusht 2019

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

1. HYRJE

Aktiviteti Ambalazhim Tregtim Uji te Pishem ndodhet në zonen e Rrajces, Fushë Prrenjaz, Librazhd, ky vlerësim teknik bëhet nga Subjekti FATOS GEGA

Me këtë Përmbledhje Jo teknike jepet informacion për subjektin , vlerësimin e ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis, si dhe proceset e punës që kryhen në këtë subjekt.

Subjekti do ti nënshtrohet procedurave për pajisje me Leje Mjedisit te Tipit B në bazë të ligjit Nr.60/2014 Për një ndryshim ne ligjin nr.10448,date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit",te ndryshuar, me kodet perkatese : Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to 7.7,

g.Prodhim dhe ambalazhim i pijeve jo alkoolike ----T ë gjitha instalimet ----



2. KUADRI LIGJOR

- L I G J Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT"
- L I G J Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"
- L I G J Nr. 162/2014 "PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS"
- UDHËZIM Nr. 1, datë 19.2.2018 "ËR MIRATIMIN E KËRKESAVE MINIMALE PËR HARTIMIN E PLANEVE TË VEPRIMIT PËR ZHURMAT"
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11,2007 "Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisete caktuara"
- L I G J Nr.10 463, datë 22.9.2011" PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE"
- L I G J Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS"
- Udhezim per dokumentacionin e duhur per "Leje Mjedisore"

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti është I regjistruar në QKB me numër nip-ti L43707404S, me adresë zona Rrajce, Fushe Prrenjaz, Librazhd. Subjekti është i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i këtij subjekti ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësise dhe përndiqet dhe zbatohet me rigorozitet menaxhimi i cilësise në të gjitha hallkat e tij. Aktiviteti që kryen ky subjekt zhvillohet pa shkaktuar ndotje të mjedisit apo të komponenteve të tij.





Uji në formën e tij të pastër, është lëng pa shije dhe pa erë po ashtu dhe nuk ka ngjyrë. Ai është i domosdoshëm për të gjitha format e jetës dhe njihet edhe si tretësi më i gjithanshëm. Pa të, jeta siç e njohim ne, do të ishte e pamundur. Njeriu humbë çdo ditë rreth 1.5 deri 2.5 litra ujë, gjë që duhet zëvendësuar me anë të pirjes së rregullt të ujit. Rreth 2/3 e peshës trupore përbëhet nga uji. Kjo sasi uji nuk është e njejtë tek të gjithë, varet nga mosha dhe gjinia. Uji është lëngu më i përhapur në tokë. Formula kimike e tij është H_2O . Uji i përshtatshëm për t'u pirë nga njeriu quhet ujë i pijshëm. Uji që nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, por që nuk është i rrezikshëm për njerëzit quhet ujë i sigurt.

Nga mungesa e ujit rritet rreziku i sëmundjes së veshkëve, bllokimi dhe infeksioni i rrugëve të urinimit, tharja e lëkures dhe mukozes, që mundëson depërtimin më të lehtë të virusëve dhe bakterieve në mbrendi të trupit.

Uji duhet të jetë i pasur në minerale të dobishme për trupin e njeriut. Ndër mineralet e dobishme përmenden: Magnezi që mbron zemrën, veshkat, sistemin muskular dhe ndihmon tretjen, Kalciumi si element integruar i kockave dhe i rëndësishëm për sistemin dentar, Bikarbonatet në sasi të konsiderueshme ndihmojnë tretjen dhe janë pozitive për asimilimin e energjisë në formën e duhur, etj. Substancat që duhet të jenë prezente në sasi të limituara janë Natriumi i cili në sasi të mëdha pengon procesin e qarkullimit të ujit në organizëm, Nitratet që janë substanca ndotëse dhe gjithashtu produkti nuk duhet të shfaqë asnjë prezencë Nitritesh.

Uji duhet të jetë i lehtë dhe pak i mineralizuar. Sasia e mineraleve të tretura në ujë është një tregues bazë për ujin mineral natyral, paraqitur në etiketë në formën e parametrut “Mbetje e thatë në 180°C në mg / l”. Sa më e ulët të jetë kjo vlerë, aq më i mirë është uji. Ujërat me mbetje të thatë nën 150 mg/l konsiderohen ujëra të lehtë.

Aktiviteti “Fatos Gega” e ushtrone aktivitetin e tij në zonën Rrajce, Fushë Prrenjaz, Librazhd. Me një sipërfaqe të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit ku sipërfaqja e aktivitetit është 169 m², me numer pasurie 25/1/2, zone kadastrale 3203.

Hyrja për në aktivitet kryhet direkt nga rruga ekzistuese. Ndërtesa ku ushtrohet ky aktivitet është një katëshe me të gjithë aksesorët e domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit.

Cdo gjë është e mirëmbajtur me kujdes nga stafi i punës dhe brenda rregullave etike. Cdo proces kryhet sipas teknologjis përkatëse. Ku cdo punëtor ka procesin e caktuar të punës.





Përshkrimi teknologjik

Ndërtesa ku kryhet aktiviteti Amballazhim Tregtim Uji te Pishëm është Brenda standarteve të kërkuar për procesin teknologjik të punës. Nga ky aktivitet nuk kemi të bëjme me rigjenerim të mbetjeve. Subjekti nuk përbene rrezik për zhvillimin e tij pas cdo gjë është kundrejte rregullove standarte . Punonjësit janë të trajtuar dhe specializuar në fushat përkatëse për punësimin në kete aktivitete.

Subjekti përdor lënde të parë 100 % uji natyral nga burimi , ku i nënshtrohet një procesi teknologjik për pastrimin dhe sterilizimin e tij sipas standarteve te BE dhe për ta bere sa me konkurues ne treg, ku cikli i prodhimit dhe ruajtjes është teresisht i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit pra është miqesore me mjedisin pasi nuk ka asnjë lloj mbetje.

Zhurmat janë normale dhe janë të pranishme vetem gjate orarit të punes . Nuk ka shkarkime te ndryshme në ambient. Furnizimi me uje dhe energji është i plote dhe me kontrata te rregullta me OSHEE.

1.Paisjet dhe Skema teknologjike e linjes se prodhimit te ujit

1.1 Para Filtra per ujin

1.2 Matesi I ujit

1.3 Filter me kuarc Filter me karbon Filter uji 1 mikron Ozonator

1.4 Paisje e larjes se shisheve; Paisje e mbushjes se shisheve

1.5 Pajisja e dezinfektimit

1.6 Pajisja e etiketimit

1.7 Mbushja dhe Etiketimi e cila behet konforme te gjitha rregullive dhe standarteve me te mira ne treg.

Subjekti është cilësuar si nje nder subjektete me garanci të sigurt për sigurinë e pirjes së ujit të pishem.

Cikli i punës është tërësisht i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me elementet e mjedisit pra është miqesore me mjedisin.

Subjekti ka hapësira dhe mjedise të cilat shërbejnë për procese të ndryshme pune si:

- Nje Zyre
- Nje magazine
- Dhoma zhveshje
- Mjediset sanitare
- Mjedis te pershtatshem per parkim etj

Masat e sigurise në mjediset e punës :

1. Gjate proceseve të punës duhen pasur parasysh këto masa sigurie:

1.1 Sigurimi i puntoreve,

1.2. Vendi i punës i përshtatshëm për punëtorët

1.3.Veshjet e punës

1.4.Temperatura e përshtatshme në ambientet e punës,

1.5.Një ambient i ndricuar mjaftë mirë,

1.6. Kutia e ndimës së shpejtë

***IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN**

Një mjedis i qëndueshem shumilon një mireqenje të mire, një drite jeshile ku ne të gjithë duhet të jemi të bashkepuntore në mirembajtjene e mjediseve nga ku ne rrethohemi; Nje mjedis i paster një jete me shume, nje frymarje me e qete, një shikim më i mire, një hap me i sigurt për të gjithë. Edukimi mjedisore është një drite për komunitetin në trësesi, për botekuptimin e gjere qe perfshin fjala mjedis i mbrojtur.

Problemet mjedisore janë kryesisht të lidhura me ndikimin e aktivitetit njerëzor mbi burimet mjedisore. Këtu perfshihen:

- Ndikimet ne toke
- Ndikimet ne ajer
- Ndikimet nga zhurmat
- Ndikime ne ujera

Subjekti ka marë në konsiderate këto pika:

- Proceset teknologjike te procesit te punes
- Mirëmbajtja dhe operimi e ambientit ku ai punone;
- Monitorim i mjediseve
- Vlerësimi i shërbimeve
- Grumbullimi i mbetjeve ne vendin e caktuar
- Ndriçimi e ambientit
- Procesine e mirëmbajtjes së pajisjeve të punës kundrejte rregullave përkatese

Subjekti është i detyruar që në rast aksidentesh të njoftojë institucionet përkatëse për menaxhimin e situatave me qëllim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut që mund të jete për zonën përreth.

Ju faleminderit

Fatos Gega